



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"



UNIVERSITETI I PRIZRENIT
"UKSHIN HOTI"



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"MAZHI ZEKA"



UNIVERSITETI I MITROVICËS
ISA BOLETINI



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"KADRI ZEKA"



UNIVERSITETI I GJAKOVËS
FEHMI AGANI



UNIVERSITETI
I SHKENCAVE TË APLIKUARA
FERIZAJ

Datë: 28.01.2019

- Për:** Presidentin e Republikës së Kosovë, Shkëlqesisë së Tij z. Hashim Thaçi
- Për:** Kryetarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Shkëlqesisë së Tij z. Kadri Veseli
- Për:** Kryeministrin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Shkëlqesisë së Tij z. Ramush Haradinaj
- Nga:** Konferenca e Rektorëve të Universiteteve Publike të Republikës së Kosovës
- Lënda:** **KËRKESË PËR VEPRIME URGJENTE NË MBROJTJEN E SISTEMIT TË ARSIMIT TË LARTË PUBLIK NGA DEGRADIMI**

I nderuar President, z. Thaçi,

I nderuar Kryeparlamentar, z. Veseli,

I nderuar Kryeministër, z. Haradinaj,

Konferenca e Rektorëve e Universiteteve Publike të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 28 janar 2019, ku morën pjesë gjashtë (6) rektorë të Universiteteve Publike, shqyrtoi gjendjen në universitete publike si pjesë e sistemit të arsimit të lartë në Kosovë.

Konferenca e Rektorëve konstaton se:

1. Institucionet publike të arsimit të lartë në Kosovë i janë nënshtruar një presioni disa vjeçar nga grupet e interesave politike dhe biznesore.
2. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Qeveria e Kosovës nuk ka udhëheqë gjithmonë politika parimore në mbrojtje të universiteteve publike.
3. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë nuk ka bashkëpunuar me universitetet publike, përkundrazi e ka penguar zhvillimin e tyre, duke mos proceduar në Kuvendin e Kosovës, statutet e tyre për miratim.

4. Është sulmuar autonomia institucionale, akademike dhe financiare e universiteteve publike. Emërimi i anëtarëve të Këshillave Drejtues të universiteteve është bërë mbi baza politike.
5. Përfshirja e Agjencisë Kosovare për Akreditim (AKA) nga The European Quality Assurance Register for Higher Education (EQAR) është pasojë e kësaj fushate. Gjithashtu, emërimi i anëtarëve të ri të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KSHC), është bërë nën tryzni politike dhe tryzni anti-universitet.
6. Vendimet e fundit të AKA për mbylljen e shumë programeve studimore të universiteteve publike, posaçërisht të universiteteve të reja publike (40% të programeve që përfshijnë përafërsisht 70% të studentëve), në mënyrë antiligjore është pjesë e kësaj fushate.
7. KSHC ka treguar se është në funksion të grupeve të interesit politik e biznesor, prandaj nuk është e aftë ta ndihmojë arsimin e lartë dhe as ta anëtarësojë AKA në mekanizmat ndërkombëtar.

Konferenca e Rektorëve, duke mbrojtur autonominë institucionale dhe akademike të universiteteve publike, kërkon nga organet kompetente që urgjentisht t'i ndër marrë veprimet si në vijim:

1. Shkarkimi i menjëhershëm i Ministrit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës e Teknologjisë, z. Shyqiri Bytyqi.
2. Shkarkimi i menjëhershëm i anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë,
3. Shfuqizimin e vendimeve për tërheqje dhe refuzim të akreditimit për të gjitha programet që kanë qenë të akredituara.

Konferenca e Rektorëve ndërpret të gjitha komunikimet me Ministrin e Arsimit, z. Shyqiri Bytyqi.

Konferenca e Rektorëve kërkon takim urgjent me Presidentin, z. Hashim Thaçi, me kryetarin e Kuvendit, z. Kadri Veseli dhe me kryeministrin, z. Ramush Haradinaj për të gjetur zgjidhje për mbrojtjen e autonomisë së universiteteve publike dhe të sistemit të arsimit të lartë në Kosovë.

Konferenca e Rektorëve njofton se nga nesër, datë 29 janar 2019, në universitetet publike të Republikës së Kosovës do të fillojë grevë e përgjithshme dhe protesta deri në plotësimin e kërkesave si më sipër.

Me respekt,

1. Prof. dr. Fadil Millaku, rektor i UHZ-Pejë dhe zv. kryesues,
2. Prof. dr. Marjan Dema, rektor i Universitetit të Prishtinës,
3. Prof. dr. Alush Musaj, rektor i UMIB-Mitrovicë,
4. Prof. asoc. dr. Bajram Kosumi, rektor i UKZ-Gjilan,
5. Prof. dr. Shaban Buza, rektor i UGJFA-Gjakovë,
6. Prof. dr. Agron Bajraktari, rektor i USHA-Ferizaj,

The image shows six handwritten signatures in blue ink, each corresponding to one of the rectors listed on the left. The signatures are written over horizontal lines. From top to bottom, they correspond to: 1. Prof. dr. Fadil Millaku, 2. Prof. dr. Marjan Dema, 3. Prof. dr. Alush Musaj, 4. Prof. asoc. dr. Bajram Kosumi, 5. Prof. dr. Shaban Buza, and 6. Prof. dr. Agron Bajraktari.